



Personazh
Sandra, princesha e dashur e amerikanëve

NE FAQET 14-15



Hëna
Si u "plak" duke na parë

NE FAQEN 18



Britani
Cameron & Clegg, 100 ditët e çiftit të çuditshëm

NE FAQEN 19



Shqip



Adresa e redaksisë:
Rr. Sami Frashëri,
Pallatet e Aviacionit, Nr. 4
Tel: 04 2 272 565 • 069 20 35 300
E-mail: info@gazeta-shqip.com

Drejtor **BESNIK MYFTARI**
Kryeredaktor **ALEKSANDËR ÇIPA**

Viti V - Nr. 229 (1601) Eshtunë, 21 gusht 2010 E përditshme e pavarur Çmimi 50 lekë, 1.5 euro

www.gazeta-shqip.com

Ministrat nisin ankesat: Oldashi për Kalimashin, Ruli për ullinjët, Meta për ambasadat

Buxheti 2011 mbërrin në qeveri, tkurren investimet

Zululand

E KEQJA ËSHTË SE NUK KEMI OPINION PUBLIK

MUSTAFA NANO

Ka përkufizime të ndryshme mbi opinionin publik. Shpeshherë janë aq të ndryshme, sa duket se nuk përkufizojnë të njëjtën gjë. Fjala vjen, në enciklopedinë britanike thuhet, se opinioni publik është agregati i sjelljeve, pikëpamjeve, apo besimeve individuale mbi një çështje të caktuar, të bartura e të shprehura nga një masë e madhe njerëzish. Dikush zë dhe e lexon këtë përkufizim...

NE FAQEN 8

TË VRITESH SI GREK!

MONIKA SHOSHORI STAFA

Teprimi është shprehje e diletantizmit dhe e amatorizmit, ose, për ndryshe, e parodisë. Ky ishte mendimi që m'u rrotullua vetëtimthi në mendje duke përcjellë për të njëzetën herë a më shumë njoftimet e ditës më të fundme për krimin e Himarës. Një krim me të vërtetë barbar, po aq barbar sa dhjetëra e dhjetëra...

NE FAQEN 9



Qeveria ka në dorë planin paraprak të projekt-buxhetit të vitit 2011, i miratuar dy javë më parë në mbledhjen e radhës. I përgatitur nga Ministria e Financave, mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga Ministrat e linjës dhe institucionet e tjera, projektbuxheti parashikon rreth 395 miliardë e 206 milionë lekë shpenzime, ose rreth 24 miliardë lekë më shumë se 2010-a (e rishikuar), me rritje mbi 6 për qind. Të ardhurat në...

NE FAQEN 6

Tregim tronditës i kështillartit të Komunës Kala e Dodës Zyrtares: Më "internuan" që mos të votoja për vendimet

NE FAQEN 12

Akuza: Kallëzimet nuk i sjellin me parametra ligjorë, por vetëm me shifra Prokuroria, probleme me KLSH-në dhe doganat

Të arrestuarit janë fqinjë të viktimës

Vrasja në Shkodër, katër të dyshuarit kapen në Lezhë

NE FAQEN 21



Prokuroria ka probleme serioze me kallëzimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Doganave. Shumica e dosjeve të KLSH-së janë pushuar, ndërsa doganat i sjellin me shumë vonesë, vetëm për t'u justifikuar për kontrollat që kanë kryer...

NE FAQEN 5

Debati brenda PD-së

Rishfaqen mbështetësit e Presidentit Topi



NE FAQEN 3

VIKTIMË E INJORANCËS DHE SHPIRTNGUSHTËSISË

KIM MEHMETI

Mjafton një periudhë disavjeçare përgjumjeje, vulgaritet në arsim e kulturë, mjafton vetëm një dekadë të të qeverisë...

NE FAQEN 8

FUNDI I UTOPISË PËR "NATYRËN E NJERIUT"...

GËZIM TUSHI

Ka një gjendje sociale të turbulluar ontologjike dhe ekzistencialisht në shoqërinë tonë, që ka filluar pas turbulencave sociale...

NE FAQEN 9

Skandali

Grupi hetimor nuk ka asnjë të re për identifikimin e 13 skeleteve Varri masiv i Dajtit, një proces në kalenda

Zbulimi i varrit masiv pranë Dajtit në fillim të këtij viti vuri në lëvizje gjithë strukturat e shtetit, por deri më tani nuk është identifikuar asnjë nga personat e vrarë në periudhën e komunizmit, 13 skeletet e të cilëve ndodhen në morgun e Tiranës. Edhe pse hetimi nisi nga të gjitha institucionet njëherësh, ende nuk ka asnjë të re. Madje, edhe qeveria ngriti një Task-Forcë, me në krye zëvendësministrin e Brendshëm, Avenir Peka, për hetimin e krimeve të komunizmit...

NE FAQEN 5




Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ky përfitim drejt zhdokjes

Pensionet për merita të veçanta, kriteret për ta përfituar

NE FAQEN 24

Guri filozofal



Ernesto Sabato, 99 vjeç

MIRA MEKSI
NE FAQEN 28

Zvicër

Pas një viti debat, Komisioni Federal miraton novacionin Shpikja e shqiptarit, miratohet me ligj në Bernë

NEFAIL MALIQI, GJENEVË

Iriu 26-vjeçar nga Tetova, Shpëtim Shaqiri, është autori i zbulimit të protezave për qentë. Tashmë pajisja është miratuar të jetë pjesë e "pajisjeve" mjekësore apo metodave të përdorimit për të gjithë shtetasit zviceran. Novatori shqiptar, Shaqiri, ka deklaruar për "Shqip" se: "Më në fund, pas një viti debatesh është pranuar me ligj zbulimi im. Mbas suksesit botëror..."

NE FAQEN 25



TË VRITESH SI GREK!

MONIKA SHOSHORI STAFA

Teprimi është shprehje e diletantizmit dhe e amatorizmit, ose, për ndryshe, e paradisë. Ky ishte mendimi që m'u rrotullua vetëtimthi në mendje duke përcjellë për të njëzetën herë a më shumë njoftimet e ditës më të fundme për krimin e Himarës. Një krim me të vërtetë barbar, po aq barbar sa dhjetëra e dhjetëra krime të ngjashme që ndodhin tashmë rregullisht gjatë "muajve të ferrit", siç quhen

prej vitesh korriku dhe gushti, muajt kur aksidentet, vrasjet, larjet e hesapeve të mërgimtarëve të kthyer dhe të vendësve sigurisht, arrijnë deri në 50. Por, ndryshe prej tyre, ky krim u kthye në çështje më vete, kombëtare dhe ndërkombëtare, etnike e ndëretnike, politike e diplomatike, qeverisëse e joqeverisëse.

Aq shumë personalitete e zëdhënës u ngritën më këmbë për të denoncuar krimin që ndodhi në Himarë, sa që njeriut nuk i mbetet gjë tjetër veçse të dyshojë mbi një të vërtetë të shenjtë, mbi një të

vërtetë biblike, që individët para vdekjes janë të barabartë, dhe pastaj të mendosh me dëshpërim: Mëkat që këta të tjerët, që ikën kësaj bote gjatë korrikut dhe gushtit prej plumbave, thikave apo aksidenteve, nuk qenë lindur diku ku ndërthuren interesa të dy shteteve, të dy vendeve fqinje, të cilët, jo shumë larg prej kësaj dite, do të jenë pa kufij politikë e shtetërorë midis tyre. Mëkat që nuk je lindur pak minoritar, pak vorioepiriot! Ose, së paku, është mirë të vdesësh duke qenë formalisht i tillë. Sepse në këtë rast do të

merren me ty Presidenti, Kryeministri, ministri i Jashtëm, kryepeshkopi, Himara, Gjirokastra, Tirana, Athina, Brukseli; do të vajtojë për ty gjysma e Shqipërisë e gjysma e Greqisë, do të shahet për ty Vlora e Labëria, do të mburret për ty gjithë aradha vijimtare e Spiro Milos së historisë, madje do të marrë pjesë në zi e në përzji edhe Kosova!

Por ndërsa i shkon në mendje të gjitha këto, nuk mund të rrih pa e pyetur veten: Çudi, pse nuk ndodhin të tilla përdorime kur ka ngjarje të rënda në

Dropull, ku dihet e njihet nga shqiptarët dhe grekët se ekziston e banon një popullsi konsistente etnikisht greke; një minoritet që njihet me këtë status qysh në periudhën e mbretërisë, pastaj dhe të totalitarizmit? Pikërisht kjo është pyetja që mund ta çojë mendjen njerëzore drejt së vërtetës. Sepse në Dropull, çështja është shumë e qartë dhe nuk ka asgjë për të ndarë, për të zvogëluar, për të zmadhuar, për të përdorur, për të keqpërdorur. Tirana e njeh popullsinë si greke, Athina është e kënaqur me këtë.

Që pika e fundit të mos mbushë gotën e urrejtjes

DR. IGLI TASHI*

Është e qartë dhe prej shumë vitesh tanimë është e pritshme – në verë vijnë ATA, siç i quajnë rëndom në Shqipëri "xaxiqë" apo "pepino" për t'u çmallur me familjet, për të pushuar nja dy-tri javë pa frë... dhe natyrisht për të ekspozuar sadopak "suksesin" e tyre apo dhe idetë që kanë krijuar për këtë Shqipërinë tonë gjatë gjithë këtyre muajve mungesë. Një ndër ta ishte dhe Aristoteli... një ndër ta isha dhe unë... dhe që të dy për pak sa nuk u takuam në Himarën e bukur.

Me vete, përveç valixheve të mbushura me rroba dhe dhurata, kokës së mbushur me halle dhe frustracione... sjellin dhe problematika që diku-diku krijojnë divergjenca ndërmjet tyre dhe "autoktonëve". Këta të fundit, në tokën me halle të Shqipërisë, kalojnë jo vetëm ditët gazmore të verës, po dhe ato të vjeshtës me shi e baltë, të dimrit të ftohtë e pa ngrohje, të pranverës me lule dhe pluhur.

Ndoshta të dy u nisëm për në këtë vend jo vetëm për bukurinë dhe detin Jon, po dhe për të ekspozuar dhe vërtetuar "idetë shabllon" që kishim në mendjet tona. Unë bëra shumë kujdes që në valixhen time, e vetmja gjë që të mos mungonte, të ishte fanella e kombëtares me shqipen e zezë në gjoks, pasi kisha një merak të madh ta vishja në "Himarën e Bollanos". Ndoshta si unë dhe Aristoteli, me gjithë të drejtën që i jepte perëndia dhe Kushtetuta e Shqipërisë, shkoi në "Himarën e Bollanos"

të fliste gjuhën e mëmës pa frikë dhe të vërtetonte se grekë e shqiptarë, si gjelat në pullaz, çukitin pendët e zeza dhe plot pluhur rrugësh, për të sqaruar se kush është i pari i vendit.

Në atë javë që ndenja unë, u kënaqa në shtëpinë e bahçen e himarjotit mikpritës Pano, vajza ime u miqësua me mbesën e shtëpisë, paçka se nuk flisnin të njëjtën gjuhë. Të dyja komunikonin me njëra-tjetrën në gjuhën më të ëmbël, atë të të qeshurave të fëmijëve dhe bënin garë kush e kush t'i bënte sa më shumë dhurata njëra-tjetrës. Eh, ç'hoqën kumbullat e bahçes së himarjotit mikpritës ato ditë...

Folëm e diskutuam ato net të nxehta për të tëra ato gjëra që mund të kishte diskutuar dhe Aristoteli me të tjerët. Himarjoti mikpritës me theksin e tij karakteristik dhe unë me bluzën time kuqezi, pa mpleksur në këtë mes, sojin e Bollanove, Duleve, Janullatosve e Kumustaqëve, ashtu siç kemi folur me njëri-tjetrin dhe më përpara e do flasim në jetë të jetëve.

U ktheva këtu ku jetoj me dëshirën e madhe për t'u rikthyer në Himarë, për t'u larë prapë me ujin e kulluar të Jonit dhe për të shijuar prapë kumbullat e mikut himarjot.

Me keqardhje nga larg pashë se ç'ndodhi: një djalë në moshën time humbi jetën! Aksident, vrasje me apo pa paramendim: e rëndësishme është ky djalë nuk jeton më dhe një nëne i dhemb zemra.

Dhe si ato grabitqarët në qiell, soji i Bollanove e Duleve, Janullatosve dhe Kumustaqëve iu sulën trupit të Aristotelit për përfitimet e tyre meskine dhe të ulëta. Ngritën zërin në qiell për të dëgjuar këta në tokë, se Aristotelin, ndjesë pastë, e vranë barbarët shqiptarë se foli greqisht. Pinjollët (siç pretendojnë!) e shtetit që shpiku demokracinë, e shkelën atë me të dyja këmbët, që t'i hidhnin pikën e fundit gotës së urrejtjes e të derdhnin nëpër rrugë lumin e gurëve të ndarjes. E pse? Për ca vota më shumë, për ca deputetë me shumë, për ca kredibilitet e rehat më shumë.

Tarafi i tyre dhe në varr e shoqëroi Aristotelin me këngën e urrejtjes, duke sharë e mallkuar këta "shqiptarë derra vrasës". A thua këtij tarafi i ka rënë rruga ndonjëherë nga Qafa e Kërrabës për të parë e mësuar hallet e Flamur Pislit? A thua kryepeshkopi grek i kishës sonë shqiptare të jetë lutur për shpirtin e Gramoz Palushit që t'ia lehtësonte

sadopak dhimbjen nënës së tij? A thua këtij Kumustaqit, politikanit nga vendi i demokracisë, t'ia kenë prishur gjumin klithmat e emigrantëve shqiptarë në birucat mesjetare të policisë greke të shekullit të 21-të? Këta që predikojnë qytetërimin dhe merakosen për raportet "super-ekzakte" të KE-së, sa herë ju vjen rasti, e heqin këtë maskë të ffishme, për të nxjerrë në dritë fytyrën dhe ëndrrat e tyre mesjetare, më të errëta se rrasa e zezë e kryepeshkopit me mjekër të bardhë. Dhe padashur, të verbuar nga injoranca e tyre, marrin pozicione qesharake duke mos pasur frikë nga diskretitimi total. Në këto raste në gjuhën tonë kemi një shprehje që thotë "Guxim prej budallai". Nëse ju shkon për shtat ky epitet, le ta gëzojnë.

Principi themelor i demokracisë që na vjen nga vendi nga i cili thotë se e ka origjinën dhe Bollanoja me faqet e kuqe e të shëndetshme, thotë *se liria ime mbaron atje ku fillon liria e tjetrit*. Pra demokraci do të thotë TOLERANCË.

Demokracinë, vendi nga i cili na frymëzohet dhe Dulja thatanik, e paraqet si një peshore dhe kjo peshore kurrsesi nuk mund të vërë në kantar as Aristotelin, as Flamurin e as Gramozin. Kjo demokraci i dënon barbarët kudo

që të ndodhen, si buzë Jonit ashtu dhe buzë Egjeut, me forcën e ligjit dhe të arsyes, duke përdorur një standard për të gjithë.

Dhe ai që mundohet të minojë tolerancën, të hedhë në erë urat lidhese apo të blloktojë rrugët, të fshehë apo manipulojë gurët e peshores së drejtësisë, mund të meritojë vetëm një epitet: atë të FAJTORIT.

Dhe që kjo të mos ndodhë duhen njerëz me integritet, njerëz që veprojnë në emër të zgjedhësve e jo të interesave koalicioniste, në emër të ligjit e jo të interesave meskine, **njerëz që kanë zemër të ndiejnë e jo kantar të peshojnë**. Ekuilibrat ballkanikë janë të brishtë dhe çdo padrejtësi ka kosto të konsiderueshme. Prandaj gjithsecili të gjykojë pjesën e fajit që i takon, duke lënë mënjanë klithmat e Mesjetës dhe duke mos përdhosur kujtimin e atyre që nuk jetojnë më në këtë botë.

Perëndia në ATË botë ua dhëntë hakun të gjithëve ashtu siç e kanë merituar... apo jo zoti Kryepeshkop? Sepse në KËTË botë sundon ligji!

Fatmirësisht himarjotë si Panoja që më priti mua e shumë të tjerë këtë vit ka shumë, e unë prapë do shkoj në Himarë, u pëlqen apo jo Bollanove me Dulet, Janullatosve me Kumustaqët. Dhe do t'ua kujtoj sa herë ta harrojnë, se ajo tokë, ai det, ato male janë dhe të miat dhe nuk ka klithma mesjetare, urrejtje apo gurë që të më ndalojnë të shkoj.

* Ekspert në çështjet e administrimit të sigurisë, Universiteti i Lozanës, Zvicër

për "natyrën e njeriut" ...

që është, njerëzit duhet të jenë ata që duhet)

individualiste të modernitetit. Kjo paqëndrueshmëri, ky instabilitet social e ka bërë shoqërinë një terren marramendës, i cili nuk po lejon që njerëzit tanë të kenë vizion të qartë, parametra standarde të sjelljes dhe mizura utilitare të vlerësimit të ndryshimeve pozitive, por dhe të deformimeve të dukshme që po pëson natyra e shoqërisë dhe "dimensioni i njeriut" modern.

Duke vlerësuar situatën që po zhvillohet në shoqërinë tonë, duke e parë atë nga "jashtë" dhe nga "brenda", nga dukja dhe thelbi, është bërë më i vështirë vlerësimi sociologjik i ndryshimeve të vullshme në marrëdhëniet subjektive dhe relacionet kaotike e në një farë mënyre edhe deterministe midis natyrës së shoqërisë dhe karakterit të njeriut. Situatat sociale dhe sjelljet individuale zhvillohen në mënyrë të paqartë dhe kjo e bën akoma më të vështirë mundësinë për të vlerësuar ndryshimet sociologjike, moralisht dhe nga pikëpamja empirike. Marrëdhëniet midis natyrës së shoqërisë dhe karakterit të njeriut janë marrëdhëniet jokompatibile. Sidomos është vështirë për të parë dhe vlerësuar në mënyrë precize mutacionet ontologjike, morfologjike dhe sociale të njerëzve tanë. Të gjithë e ndjejmë që sot ka paqartësi sociale, kaos kuptimesh dhe keqkuptimesh individuale,

ndërthurje të së vërtetës dhe iluzionit, të kërkesave ultimative, konsistente dhe të pandryshuara të realitetit empirik dhe iluzioneve e utopive sociale, që vijjnë si mentalitete penguese nga përplasia e koncepteve vlerësuese me realitetin e shoqërisë shqiptare. Kjo bën që të duket sikur jetojmë në një realitet kontroversal, në të cilin në të njëjtën kohë përzihen dhe kaotizohen "vlerat" dhe "antivlerat" sociale dhe individuale. Shumë njerëz po e ndryshojnë natyrën e tyre, pa ditur pse dhe çfarë duhet të bëjnë për të shkruar aty "ku duhet". Ca të tjerë të mbërthyer nga ide të vjetra kolektiviste, nga iluzione humane dhe mentalitete supersociale, nuk dalin dot me sukses jashtë në shoqëri dhe për pasojë mbeten "brenda vetes" të pafuqishëm, të paorientuar dhe e kanë të pamundur të ambientohen me kërkesat e saj imperative.

Kjo po krijon një shtresë sociale të njerëzve naivë, ose që nuk kanë dëshirë të vënë në lëvizje mendjen dhe të kuptojnë kohën dhe shoqërinë në të cilën jetojnë. Ata janë njerëzit tanë, por që në mënyrë naive vazhdojnë të besojnë se janë njerëz të mirë dhe të ndershëm, dhe se nuk është faji i tyre që mbeten në terrene sociale utopike. Sipas tyre, shka-ku nuk është tek ata, por është shoqëria e keqe, e cila nuk është e përshtatshme për formatin e tyre. Një gjë duhet të

kuptojnë njerëzit tanë, që këtë "filozofi jete" duhet t'ua mësojnë që në fillim edhe fëmijëve tanë. Nuk ka më shoqëri në kuptimin klasik, egalitar dhe humanist. Tani ka masa njerëzish që janë jo aq shumë të lidhur me njëri-tjetrin. Kjo e bën të domosdoshme që secili nga ne pas "vetes" të shikojë së pari "veten". Tani nuk ka më lidhje të forta shoqërore, por ka njerëz që jetojnë në shoqëri dhe janë në të duke luajtur në jetën shoqërore, por jo me dëshira utopike, por me role jetësore si individë, si prindër, punonjës, nëpunës, konsumatorë, votues, fqinj etj. Në këtë kontekst nuk është normale që të mbrojmë njerëzit që, ngaqë jetojnë në botën iluzore apo qoftë edhe virtuale, e kanë të pamundur që të bëhen të aftë, kompatibël me jetën, që të dallojnë "brenda vetes" dëshirat e tyre, që nuk duhet të formatohen si "utopi sociale". Këta njerëz në thelb janë të mirë, por janë utopikë, të papërshtatshëm për kohën. Kjo psikologji bën që pasivisht, apo duke bërë kritika nga "dritarja e shtëpisë", të qëndrojnë në pritje dhe të bëhen "viktima", që krijohet nga diferencat që ka shoqëria moderne në raportin midis "premtimeve sociale" dhe "vështirësive individuale", në realizimin e reformave reale dhe përballjen me kërkesat standarde të ekonomisë së tregut.

Midis dëshirave të ëmbla të njerëzve

utopikë dhe kostove të reformave të ashpra të jetës, është njeriu që e quan veten të mirë, edhe pse nga pikëpamja sociale është i dështuar. Pikërisht për shkak të konfliktualitetit që ka natyra e shoqërisë me natyrën e tij, nga që të qenët "utopist" në kohën tonë është jo vetëm dobësi sociale, por së pari është defekt individual, që është vështirë të thuhet se është e metë e "njeriut të mirë", apo "njeriut utopist", të paaftë dhe të paorientuar me kërkesat e shoqërisë.

Në familje, në shkollë, kudo që edukojmë njerëzit tanë, nuk është normale, e ndershme që t'i mësojmë në mënyrë të deformuar, t'i përgatisim si "qenie të squllura" që jetojnë në botë eterike dhe ushqehen me iluzione sociale utopike. Në vend të tyre koha moderne po sjell në shoqërinë shqiptare mesazhe të qarta, se ajo nuk është fort e përshtatshme as për "njerëzit utopistë", as për njerëzit e "mbushur me ideale" personale, që janë ose pa rezonancë sociale, ose që njerëzit që i kanë nuk kanë vullnet jete dhe sens praktik për t'i realizuar. Në këtë rast, jo vetëm idetë e tyre janë utopike dhe jashtë realitetit, por ata edhe në jetën praktike nuk kanë "aftësitë teknike" të përshtatjes. Ata janë të pazotë për të konkurruar dhe qenë individualisht të suksesshëm. Shoqëria shqiptare e kohës moderne nuk ka aq shumë nevojë për

njerëz që mendojnë se mund të jetojnë duke tjerë ide, apo duke teorizuar për gjëra që janë jashtë realitetit, që nuk i hyjnë në punë askujt. Përkundrazi, tani është kohë e suksesit, adoptimit me kërkesat e jetës, kohë e aftësisë teknike dhe profesionale, e vullnetit të hekurit që e bëjnë njeriun individualisht të suksesshëm në tregun e punës. Njeriu nuk mund të jetë sot as "idealist", as "utopist", por njeri i aftë që individualisht të orientohet në mënyrë sociale.

Koha e reformimit të sistemit politik social dhe ekonomik në shqiptarëve gradualisht, por në mënyrë të sigurt, po na mëson dhe po na përshtat me paradigmen e shoqërisë moderne, sipas së cilës njerëzit nuk mund të shihen më si masë sociale e "njerëzve të ngjashëm", apo si turmë morale e njerëzve që mendojnë njësoj. Përkundrazi, koha individualiste na ka vënë përballë detyrimit, që në vend të konceptit të vjetër të "masës njerëzore", t'i shikojmë dhe vlerësojmë njerëzit ashtu siç ata janë në të vërtetë. Kjo është shoqëria moderne dhe normalisht edhe njerëzit janë "ata që janë" dhe nuk duhet të presim në mënyrë utopike që të bëhen "ata që duhet të jenë". Thuhet se në kohën tonë është i vështirë dhe utopik mendimi për një rehabilitim kolektiv të natyrës njerëzore në shoqërinë shqiptare. Në rrugë tjetër ndoshta...